



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Kuvendit Komunal të Novobërdës
Z/znj _____

Në bazë të dispozitave të nenit 43 pika 43.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bazë dispozitave të nenit 36 të Statutit të Komunës së Novobërdës.

F T O J

Mbledhjen e parë të rregullt të Kuvendit Komunal e cila do të mbahet më datë: **31.01.2019** (e enjte) duke filluar në ora **10:00**.

R e n d i i d i t ë s

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e K.K-së;
2. Aprovimi i planit të mbledhjeve të Kuvendit për vitin 2019;
3. Raporti i punës së Kryesuesit për punën e Kuvendit-2018;
4. Të ndryshme.

Mbledhja do të mbahet në lokalet e K.K-së, së Novobërdës.

Më: 22.01.2018
Në: Novobërdë



Nebojsa Arsic
Kryesues i Kuvendit

N. Arsic



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e dymbëdhjetë e rregulltë e Kuvendit të Komunës së Novobërdës e mbajtur më datë 27.12.2018, duke filluar në orën 11.00.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: zv.Kryesuesi Ramush Mehmeti, anëtarët e Kuvendit: Predrag Stojkovic, Negovan Jovanovic, Ivica Cenic, Mirjana Simijonovic, Jorgovanka Filic, Dragana Dimic, Abdyl Gashi, Milica Jovanovic, Selatin Nuhiu, Dobrivoje Djordjevic, përfaqësuesi i OSBE-es, përfaqësuesit e Kfor-it dhe qytetarë.

Në mungesë të Kryesuesit Nebojsa Arsic mbledhjen e udhëheqë zv.Kryesuesi Ramush Mehmeti, pasi përshëndeti të pranishmit tha: Para se të fillojmë me mbledhjen duhet konstatuar korumin prezent janë 11 antarët të Kuvendit nga 13 gjithësej, kemi korum për punë dhe vendimarrje dhe po fillojmë mbledhjen me këtë:

Rend dite

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K;
2. Raport rreth ndarjes së materialit për shkolla dhe ambulanca në teritorin e Novobërdës;
3. Raportim për ndarjen e subvencioneve në Drejtorin e Bujqësisë për vitin 2018;
4. Të ndryshme.

Zv.Kryesuesi i pyeti të pranishmit a pajtohen me këtë rend ditë apo keni ndonjë propozim ose diskutim?.

Pasi nuk pati diskutime me 8 vota për, 3 kunder (Predrag Stojkovic, Negovan Jovanovic, Jorgovanka Filic) aprovohet rendi i ditës.

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

Pasi nuk pat diskutim proceverbali u aprovua me 7 vota për 1 kunder (Milica Jovanovic) dhe 3 apstenime nga antarët prezent të Kuvendit.

Pika e dytë: Raport rreth ndarjes së materialit për shkolla dhe ambulanca në teritorin e Novobërdës; Zv.Kryesuesi tha: ju e dini se para një viti në muajin shkurt disa shkolla kanë mbetur pa ngrohje, ne si Kuvend kemi kërkuar që të sjellin një raport nga egzekutivi se sa janë furnizuar shkollat dhe shëndetësia me materiale për ngrohje, mirëpo fatkeqësisht kjo nuk po ndodh dhe nuk po e di arsyen pse por mendoj se kjo është një neglizhencë nga egzekutivi, pasi që egzekutivi të mos raportoj për punën e vet kjo është tmerr por megjithatë është përgjegjësi e tyre, ne si antarë të Kuvendit kemi ngritur këtë shqetësim dhe e hapi diskutimin për këtë pikë.

ekzekutivi të na tregoj për punët që i kanë bërë, por me vet faktin se nuk janë prezent në mbledhje për të raportuar tregojn se nuk e kanë bërë asnjë punë për të mirën e qytetarëve, prandaj unë ju bëjë thirrje atyre që të jenë prezent në sall për arsye se e kanë pranuar ekzekutivin e kanë pranuar pergjethësin që para qytetarëve të udhëheqin dhe nese nuk janë të aftë të menaxhojnë Drejtoritë përkatëse ata të largohen nga vendet e tyre të cilat po i mbajn të bllokuar dhe nuk po bëjnë asnjë veprim në të mirë të qytetarëve, ju faleminderit.

Selatin Nuhui pasi përshendeti të pranishmit tha: pajtohem me parafolsin se ekzekutivi nuk po merr pjesë që një kohë të gjatë në seancat e Kuvendit Komunal dhe neve po na neglizhojnë, pasi që sot është seanca e fundit e vitit 2018 dhe kishte qenë më mirë që më shumë të jetë kjo seancë solemne dhe me raportu Kryetari i Komunës së bashku me stafin e vet për të arriturat e veta se qka ka bërë të mirë për qytetarët e jo totalisht me na neglizhu neve, ju faleminderit.

Zv.Kryesuesi tha: sa i përket kësaj pike ne mundë të diskutojm por nuk mundë të marrim asnjë vendim, fatkeqësishtë po shifet një neglizhenc totale e ekzekutivit, fatkeqësia më e madhe është se që një vit nuk e dim se kush është Drejtor në Drejtori Komunale, me vet faktin se nuk vijnë të raportojnë për pikat e veta, kjo dëshmon se ata nuk janë duke punuar, unë do të konsultohem për seancën e janarit që të marrim hapa konkret pasi që kemi mundësin.

Pika e tretë: Raportim për ndarjen e subvencioneve në Drejtorin e Bujqësisë për vitin 2018;

Zv.Kryesuesi tha: në kohën e fundit janë ndar 50 kultivator ne forma të ndryshme ashtu si dëgjojm por asgjë zyrtare nuk dim, ka dyshime se pjesa dërmuese është shpërnda për puntorët e Komunës kjo është papergjegjësi totale, për Drejtorin e Bujqësisë thuhet se jeton në Serbi dhe vetm merr pagë nga Komuna, qe dy seanca kam permend një gjë të till dhe Kryetari nuk vjen me raportu.

Zv.Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Abdyl Gashi tha: është pak e vështir me disku ku nuk janë Drejtorët përkatës dhe qeverisja, me vet faktin që nuk vjen asnjë raport nuk e dim se si ka ndodhur ndarja e këtyrë subvencione në bujqësi, poashtu unë kam qenë pjesë e komisionit për ndarjen e bagtive për qytetarët të cilët janë dëmtuar nga vjedhjet e kafshëve dhe asnjëher as nga Kryetari dhe as nga kabineti i tij nuk jam ftuar për të parë se si është ndarë ai buxhet, aty ka shumë parregullësi. Mendoj se ne bashkarisht duhet të veprojm sipas mundësive ligjore që me vepru në mënyrë që me ndalu këtë Kryetar të papergjegjshëm i cili sillet me Komunën e Artanes si të ishte Komuna e tij personale. Kjo Komunë është e qytetarëve dhe nuk e ka të drejten as Kryetari dhe as Drejtorët përkatës që ta mbajnë pezëll. Buxheti i Komunës është buxhet i të gjithë qytetarëve dhe kanë të drejt me u qas në dokumenta dhe me i pa shpenzimet. Në mënyr të papergjegjshëm ky Kryetar ka mbajtur pezull 5-6 muaj nuk i ka emruar Drejtorat dhe kabinetin e tij qeveritar, ku Kryetar u sjell në mënyrë të papergjegjshme edhe me punësime siç ka ndodhur me gruan e tij, unë jam i gatshem me u ballafaqu dhe me mbajt përgjegjësi për fjalët që i them, po të ishte një shtet ligjor nuk do të kishte pasur nevoj të ngrisim as kallëzime penale për ta dënuar këtë Kryetar, për arsye se një person i cili ka qenë i denuar për gruan e tij i cili e ka punësuar dhe merr pagë e asnjë ditë nuk vjen në punë, ky Kryetar sillet në mënyrë të papergjegjshme me qytetarët. Po të kisha qenë unë Drejtor nuk do ta kisha ndegju asnjëher edhe sikur ta kisha pasur pagën 1000€ nuk do të mundë të ma ndalonte të marrë pjesë në seanc sepse këtu mirren vendime për buxhetin Komunal, këtu dihet përgjegjësia dhe punët që i bëjnë Drejtorët Komunal, ju faleminderit.

Milica Jovanovic pasi përshendeti të pranishmit tha: po e parashtroj një pyetje për 50 kultivator që janë ndarë ne javën e kaluar, a ka pasur komision apo kush ka vendosur për ndarje të këtyrë kultivatorëve.

Zv.Kryesuesi tha: nese nuk ka diskutime tjera të nderuar kolegë të Kuvendit kërkoj pak vëmendje pasi që edhe para dy muajve kam kërkuar pasi që Kryetari i Komunës nuk po i raporton Kuvendit dhe është duke shkelur edhe rregulloren për ndarje të subvencioneve të aprovuar me 14.11.2012 dhe është duke shkelur nenin 3 ku shkruan se Kryetari është obligativ të raportoj për çdo buxhet të shpenzuar për subvencione, unë nga ju kërkoj që sot Kuvendi Komunal të marrë vendim që Kryetarit të Komunës ti mirret e drejta e ndarjes së subvencioneve dhe të thuhet se Kryetari i Komunës nuk ka të drejt të ndajë asnjë cent buxhet pa

Procesverbali i Kuvendit

vendim të Kuvendit, e dergojmë këtë vendim në MAPL dhe mendoj se është shumë vendim i drejt dhe legjitim. Kërkoj nga ju që të deklaroheni se a jeni për pruarje të këtij vendimi. Me 7 vota për, 3 kunder (Predrag Stojkovic, Negovan Jovanovic dhe Jorgovanka Filic) dhe 1 apstenim nga antarët prezent të Kuvendit u aprovua ky:

VENDIM

Aprovohet vendimi që Kryetari i Komunës nga kjo seanc nuk ka të drejt të ndaj buxhet për subvencione pa vendim të Kuvendit.

Pika e katërt: Të ndryshme.

Zv.Kryesuesi tha: sot në zyre të Kryesuesit pash disa kërkesa, një kërkesë është prej fshatit stanishor që kërkon të mirren masa për një kanalizim por si të marrim në ndonjë vendim kur nuk është askush prej ekzekutivit. Kërkesa tjetër është prej policisë së Kosovës ku kërkon prej Kryetarit dhe Kuvendit që ti ndahen 12 ari tokë për të ndërtuar një stacion policor, jam i sigurt se secili prej neve ish pajtuar me këtë propozim por qysh të marrim vendim pasi që ne duhet të dim se ne cilen zonë katastrale dhe në cilen parcel po miret vendimi mu nda 12 ari.

Zv.Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Dobrivoje Djordjevic pasi përshendeti të pranishmit tha: po nderlidhem me piken më herët ne nuk mundë të biem asnjë vendim pa biseduar, sikur se tani që e pruum këtë vendim.Sa i përket kësaj kërkesë unë në komitet për komunitete kamë dëgjuar këtë kërkesë dhe kam dhënë propozime që policia të kaloj prej kategoris B në C, e kundërshtoj që të ndertohet përseri stacioni policor në Bostan kur është stacioni në Novobërdë por kërkoj qe te ndertohet edhe nje nenstacion ne Stanishor qe do ta mbulonte me lehtë atë teritor si Kuvcen Stanishorin e Koretishten.

Zv.Kryesuesi tha: po pajtohem me ty plotësishtë se puna duhet të shkoj në kordinim me egzekutiv-Kuvend, unë sotë kam ardhur në ora 09:45 pasi që më ka thënë Kryesuesi që ta zavendesoj, kam ardhur më heret në zyre të Kryesuesit dhe kam pritur nese ka dikush me shtu ose me propozu diqka, nuk kam keq me askënd por ne nuk mundemi me i shty proceset me nese ata nuk dojnë të punojnë. Çdo herë që vjen një kërkesë dhe është në të mirë të qytetarëve ne duhet ta përkrahmi, ne si të marrim vendim sot edhe pse kërkesa është shumë e qartë prej policisë por ne duhet ti lëjm emer dhe të themi se Kuvendi Komunal sot morri vendim që me ja nda stacionit policor të Novobërdës një parcel prej 15 ari në këtë zonë katastrale me këtë fletë poseduese.

Dobrivoje Djordjevic tha: pajtohem me ju me atë që thatë por tash u lus që mos të bini asnjë vendim, por të bisedohet njëherë, nuk duhet qytetarët të pësojnë, gjithashtu në fshatin Stanishor të gjitha shktat janë të hapura dhe askush nuk intervenon.

Selatin Nuhui tha: po nderlidhem me objektin në fshatin Prekovic, zyren e komuniteteve përkatësishtë, para tre muajve pat ardhur këtu një drejtor për me kalu në Kuvend kërkesen e tij për një shoqatë të bletareve, ne jemi një komisioni i formuar prej Kuvendit dhe jam pjesë e atij komisioni dhe nuk na kanë marrë parasysh ne si komision, tash ai objekt funksionon dhe ju ka lshu shoqates së bletarëve pa njoftuar komisioni për dhënje të pronave në shfrytëzim,

Predrag Stojkovic pasi përshendeti të pranishmit tha: e kam një informat për sherbimin e Komunës, ne kemi formuar listen e partive dhe kemi zgjedhur Kryetarin e kësaj partie që është zgjedhur Kryetar i Komunës por disa antarë kanë kaluar opozit andaj unë ju njoftoj se nga sotë nuk jam antar i LS por antarë i pavarur i Kuvendit do të vazhdoj të punoj njejt dhe në të mirë të gjithë qytetarëve, ju faleminderit.

Milica Jovanovic pasi përshendeti të pranishmit tha: për zyren e Drejtorise në Prekovic kur votova kunder procesverbalit ke për arsye se kam thënë për zyren e Drejtorisë nuk e di se si është dhënë në shfrytëzim e nuk kamë thënë se nuk ushtron asnjë veprimtari.

Zv.Kryesuesi tha: keni të drejt por mund të ketë gabime edhe gjatë perkthimit, por ky gabim do të permirësohet në procesverbalin e ardhshëm.

Abdyl Gashi tha: po nderlidhem te kërkesa e stacionit policor, ku kemi mbajtur edhe seanca të jashtëzakonshme për vjedhjet e fundit të cilat janë bërë normale në Komunën tonë, kemi kërkuar prej

Procesverbali i Kuvendit

Abdyl Gashi tha: po nderlidhem te kërkesa e stacionit policor, ku kemi mbajtur edhe seanca të jashtëzakonshme për vjedhjet e fundit të cilat janë bërë normale në Komunën tonë, kemi kërkuar prej Kryetarit që të ketë një bashkëpunim më të madhë me policinë, me sa duket as kjo kërkesë nuk është marrë me seriozitet nga Kryetari që ta shqyrtojë dhe bashkarisht të nxerrim një vendim që të ndajm një pronë për stacionin policor. Këto vjedhjet do të vazhdojnë në një ritëm shumë më të madhë derisa institucionet Komunale nuk e kanë një bashkëpunim, këtu nuk është formuar as KKSBJ-ja. Këto qështje nuk po mirren seriozisht nga Kryetari i Komunës, pothuajse qe 5-6 vite është ritëm i vjedhjeve të mëdha dhe po rrezikohen njerëzit edhe të humbin jetë dhe asnje hajn nuk është zbuluar. Andaj ju bëjë thirrje edhe kryetarit dhe policisë që ti zbulojn të dyshuarit dhe të dalin para drejtësisë, nuk kam tjera pyetje pasi e kemi të pamundur me ngrit shqetësimet tona kur Drejtorat nuk janë prezent.

Predrag Stojkovic tha: nuk e di ajo kërkesë a ka arritur te Kryetari i Komunës, nuk e di se a egziston bashkëpunim, pajtohem që gjithëmonë do të jetë në interes të qytetarëve dhe kishte qenë më mirë që nënstacioni i dytë të jetë në Stanishor, pasi që ndihmon pjesën poshtë të qytetarëve, për këtë qështje duhet të bisedojm me Kryetarin dhe të shikojm se ku kemi mundësi të jepet ajo tokë për këtë nënstacion.

Mirjana Simijonovic pasi përshendeti të pranishmit tha: vetem dua të them se unë jamë anatre e KPF-së dhe me pergjegjësi them se askush nuk është sjell keq dhe askush nuk e ka larguar Kryetarin nga por vet është larguar, ju faleminderit.

Milica Jovanovic tha: askush asnjëher nuk e ka larguar Kryetarin nga KPF-ja.

Zv.Kryesuesi tha: po pajtohem plotësishtë pasi që askush askënd sun e largon prej Kuvendi pasi që jemi zgjedhur nga populli dhe populli na largon, Kryetarin smund ta largoj askush pasi që ai e ka vendin e rezervuar. Unë po e shoh disponimin e të gjithë antarëve që të punojm në të mirë të qytetarëve, ne çdo Komuna i shoh se Kryetari ka mbajtur dy degjime publike, ne si Kuvend kërkojm që të raportojne për punën e tyre pasi që janë obligativ me ligj. Asistentja ju dergon ftesat Drejtorëve, Kryetarit, Nënkryetarit se në këtë datë mbahet mbledhja a ka ndonjë pikë për rend dite por nuk sjellin pika për Kuvend.

Dobrivoj Djordjevic tha: nuk është duhur që të biem ndonjë vendim të kunderligjshëm, kolegu më heret mirë tha se pa bashkëpunim të egzekutivit me Kuvendin qytetarët pësojn, nese keni dëshmi se dikush ka vjedhur egziston policia dhe organet kompetente.

Abdyl Gashi tha: tendenca për me bo fajtor Kuvendin nuk është legjitime, fajtor janë Kryetari i Komunës, Drejtorat që nuk janë prezent dhe kjo nuk ka vend për vajtim gjoja se ne po sillemi keq ndaj Kryetarit apo ndaj një Drejtori, ne jemi duke e bërë punën tonë shumë legjitime, po kërkojm raport prej Drejtorive të caktuara dhe prej Kryetarit të Komunës që e ka obligim ligjor, po kërkojm degjim publik me qytetarë se ku po i shpenzojn mjetet, unë jam për me bashkëpunu për të mirën e qytetarëve dhe mendoj se kundërshtime tonë vlejne për Kryetarin që ai me punu punë më të mirë, nese Kryetari nuk është i zoti me qeveris me punën e Komunës është shumë e thjeshtë, largohesh jep dorëheqje dhe vjen dikush që e bënë kabinetin më të mirë dhe punën më të mira dhe udhëheq më ndershem. Bashkëpunimi yne është këtu në Kuvend vjen Kryetari dhe kërkojm llogari prej ti.

Selatin Nuhiu tha: kolegy yne e permendi kunder efektin por nuk e di se qfarë kunder efekti po flet kur secili e kryen punën e vet kur ne po kërkojm që disa seanaca bashkëpunim me Kryetarin e Komunës. Sa i përket auditorin ne nuk kemi raport as auditorit të brendshëm as të jashtëm për këtë vit, kjo tregon se sa serioz është egzekutivi ndaj Kuvendit.


Zv.Kryesuesi tha: nese nuk ka diskutime tjera ju uroj një vitë të mbarë, dhe ju ftoj që të vini në zyre të Kuvendit që të merrni nga një kalendar.

Pasi nuk pat diskutime tjera zv.Kryesuesi i falenderoi të pranishmit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:55.

Valmire Mustafa

Procesmbajtëse



Ramush Mehmeti

Zv. Kryesuesi i Kuvendit





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

DATE/A:	09.01.2019
PËR/ZA/TO:	Antarët e Kuvendit Komunal
NGA/OD/FROM:	Nebojsa Arsic - Kryesues i Kuvendit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Propozimi i orarit të mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit Komunal për vitin 2019

Të nderuar,

Në bazë të nenit 43.6 të Statutit po ju dërgoj orarin e mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit të Komunës për vitin 2019.

Nr	Dita	Data	Koha	Vendi
1.	E enjte	31.01.2019	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
2.	E enjte	28.02.2019	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
3.	E enjte	28.03.2019	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
4.	E enjte	25.04.2019	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
5.	E enjte	30.05.2019	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
6.	E enjte	27.06.2019	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
7.	E mërkurë	31.07.2019	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
8.	E enjte	05.09.2019	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
9.	E hënë	30.09.2019	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
10.	E enjte	31.10.2019	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
11.	E mërkurë	27.11.2019	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
12.	E enjte	26.12.2019	10:00	Salla e Kuvendit Komunal




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Kryesuesi i Kuvendit Komunal
z.Nebojsa Arsic



RAPORT I KRYESUESIT PËR PUNËN E KUVENDIT PËR VITIN KALENDARIK
2018

Janar 2019

Të respektuar/a

Anëtarë/e të Kuvendit Komunal të Novobërdës.

Ju drejtohem si Kryesues i Kuvendit të ju raportoj për punën një-vjeçare të Kuvendit Komunal të Novobërdës, duke i përmbledhur rezultatet në çdo fushë, kështu edhe Kryesuesi i Kuvendit ka obligim që për punën vetë dhe të Kuvendit ti njoftoj ata me të cilët së bashku punon për të përmbledhur kualitetin e punës, si dhe të gjithë atyre që janë të lidhur me Kuvendin pa të cilët nuk mundet të punoj dhe realizoj qëllimet e veta: Kryetarin, Drjetorët, Ministrit kompetente e në fund edhe ata që janë më të rëndësishmit e na kanë dhënë besimin, që t'i prezentojmë në këtë organ, e ata janë qytetarët e Komunës sonë. Gjithashtu kam knaqësinë që jamë në krye të një Kuvendi multietnik, për të cilën mundë lirishtë të them që paraqet një shembull të mire të bashkpunimit në mesë të Këshilltarëve të Komuniteteve të ndryshme ku në planin e pare është bashkëpunimi në mesë të anëtarëve të komuniteteve të ndryshme dhe kanë për qëllim realizimin e kushteve më të mira të jetës për qytetarët e vetë.

Siç është e ditur Kuvendi Komunal mbështetet në aktet juridike, duke filluar nga Ligji për Vetqeverisjen Lokale, si aktin më të lartë e përmes statutit si aktin më të rëndësishëm të Kuvendit, rregullores së Kuvendit dhe akteve tjera që i aprovon Komuna. Në këtë drejtim në bazë të nenit 43.2, Ligjit për Vetqeverisje Lokale, si dhe nenit 43.2 të statutit, Kuvendi i Komunës është e obliguar t'i mbajë dhjetë mbledhje të rregullta gjatë vitit, edhe ate pesë në pjesën e pare të vitit dhe pesë në pjesën e dyte. Me knaqësi mundë të konstatoj se kemi vepruar në bazë te nenit 43.2 LVL, si dhe nenit 43.2 të statutit në kuptimin e përmbajtjes së afateve për mbajtjen e mbledhjeve. Përpos 12 mbledhjeve të rregulltave i kemi mbajtur edhe një të jashtëzakonshme dhe një urgjente. Të gjitha mbledhjet janë mbajtur në bazë të planit vjetor të punës.

Në mbledhjet e rregullta dhe jashtëzakonshme të mbajtura kemi aprovuar:

1. 36 vendime, dhe të gjitha janë verifikuar nga ana e Ministrisë kompetente për vetqeverisje lokale, vetem 1 vendim ka qenë në kundërshtim me ligjin;


Duke vepruar në bazë të nenint 51.1, 51.2 dhe 53.1 te Ligjit mbi Vetqeverisjen Lokale dhe nenit 40.1 dhe 40.2 te Statutit Komunal, jane formuar komitetet e perhershme si:

- 1.Komitei për Politikë dhe Financa;
- 2.Komiteti për Komunitete;

Përpos këtyre dy Komiteteve janë formuar edhe komisionet për kryerjen e punëve të caktuar për Komunën e Novobërdës.

- 1.Komisioni Komunal për emrimin e rrugëve;
- 2.Komisioni Komunal për verifikimin e kordinatave në terren;
- 3.Komisioni për ndryshimet në Rregulloren për pagesen e tatimit në pronë;
- 4.Komisioni për shqyrtimin e kërkesave të qytetarëve për dhënjën në shfrytëzim të tokës Komunale.

Të nderuar antarë të Kuvendit në fundë të këtij raporti deshiroj t'ju falenderohem për bashkpunimin dhe kontributin e juaj në punën e Kuvendit. Çdo propozim u juaj është i mirëseardhur, shpresoj që në këtë vit të kemi më shumë bashkpunim me Këshillin Egzekutiv dhe me angazhimin tone, me sjellje të mirfilltë mundemi të realizojmë rezultate më të mira në Kuvendë ku e gjithë kjo do të reflektohet në përmisimin e shërbimeve për të gjithë qytetarët, dhe shërbimet tjera si dhe ngritja e nivelit të infrastruktures Komunale.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së
Novobërdës

A. Arsic

Nebojsa Arsic